

REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - PRILL 2024

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	03.04.2024	Kërkesë për informacion për dhënie leje	12.04.2024	<p>Në përgjigje të shkresës Suaj, nëpërmjet së cilës, kërkoni të informoheni si dhe t'ju vendoset në dispozicion një kopje e dokumentacionit ku është bazuar dhënia e Lejes së Ndërtimit..., ju bëjmë me dije se: Këshilli Kombëtar i Territorit në mbledhje, ka marrë Vendimin ..., në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga ana e AZHT-së përpara miratimit të lejës së ndërtimit, ka rezultuar se zhvillues i pronës objekt leje është shoqëria... e cila është dhe pronare e pasurive objekt zhvillimi, vërtetuar nga dokumentacioni i dorëzuar nga aplikuesi, ashtu edhe nga konfirmimi i statusit juridik të pasurive nga ASHK Drejtoria Vendore Durrës. Gjithashtu nga konsultimi me të dhënat në ekstraktet e QKB-së nuk figuron që z...të jenë aksioner të shoqërisë, apo midis tyre të ketë ndonjë pasur marrëveshje bashkëpunimi. Për sa më sipër, për t'ju ardhur në ndihmë, bashkëlidhur Ju lutem gjeni dokumentacionin</p> <p>Ky vendim, së bashku me hartën që i bashkëlidhet, janë të aksesueshme për të gjithë subjektet, ashtu sikurse të gjithë Vendimet e tjerë të Këshillit Kombëtar të Territorit, në adresën zyrtare të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit: http://www.azht.gov.al, në rubrikën "Vendime KKT"</p>	E plotë	Nuk ka

2	04.04.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të informacionit mbi dhënien e lejeve të ndërtimit të shoqërisë	16.04.2024	<p>Në përgjigje të shkresës Tuaj, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Agjencia e Zhvillimit të Territorit në mbështetje të Vendimit Nr.725, datë 02.09.2015 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, është institucioni që ushtron funksionet e Sekretariatit Teknik të KKT-së dhe si e tillë, ka si kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit tekniko-ligjor që shqyrtohet në mbledhjet e KKT-së, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit dhe/apo ndërtimit, si dhe monitorimin dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit për lejet e ndërtimit të cilat miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit.</p> <p>Në zbatim të Vendimit Nr.408, datë 13.5.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar”, nga verifikimet e kryera nga ana jonë lidhur me subjektin në fjalë, rezultojnë se jemi përzgjedhur nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve për kontrollin e përputhshmërisë me instrumentet e planifikimit në fuqi dhe vendimmarrjes së KKT-së për objektin....., pajisur me leje ndërtimi ..</p> <p>Ndërkohë, lutemi ti drejtoheni Bashkisë Tiranë për informacion si autoriteti përgjegjës për zhvillimet brenda territorit të saj administrativ .</p>	E plotë	Nuk ka
3	11.04.2024	Kërkesë mbi pasuritë e trashëguara dhe mosnjohjen e ndërtimeve aktuale.	02.05.2024	<p>Në përgjigje të shkresës Suaj, ku ju pretendoni se nuk i njihni ndërtimet e kryera mbi pronën ju trashëgoni, pasi janë ndërtuar pa miratimin tuaj dhe bazuar në dokumenta pronësie të fallsifikuara, ju bëjmë me dije se: Dokumentacioni që administrohet nga ana e AZHT-së për çdo aplikim që paraqitet pranë tij në sistemin e-Leje, vjen në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr.408, datë 13.05.2015 "Per miratimin e rregullores se zhvillimit të territorit" (i ndryshuar), ku parashikohet në mënyrë të detajuar i gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor që duhet të paraqesin aplikuesit për miratimin e lejeve të zhvillimit, konkretisht Neni 10 “Dokumentacioni për pajisje me leje zhvillimi” kundër të tjera dokument themelorë përmendet "dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe nëse ka, kopje të marrëveshjes për pronën;...”(pika 1, shkronja “c”).</p> <p>Po ashtu për sa i përket lejeve të ndërtimit, Neni 16 "Permbajtja e lejes së ndërtimit", gërmat "d" dhe “dhe”, të VKM-së sipërpërshkruar theksohet se në dokumentin e lejes së ndërtimit, përcaktohen (krahas autoritetit përgjegjës që lëshon aktin, identitetin e zyrtarit që përfaqëson autoritetin, etj.. edhe “... të dhënat identifikuese të pronarit të tokës dhe adresa e kufinjve të pasurisë” të cilat në vetvete përbëjnë informacionin që ofrohet nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës apo Drejtoritë Vendore të saj"</p>	E plotë	Nuk ka